

Tiranë, më 28.01.2022

## VENDIM

### I

#### ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE

Sot, më datë 28.01.2022 Asambleja e Përgjithshme e ortakëve të shoqërisë "HËNËZA" sh.p.k, një shoqëri e themeluar rishtazi e përbërë nga 2 (dy) Ortaket :

- Zonja Marinela Xherimeja me Numër Personal ID J55606060W lindur ne Berat, me 06.06.1995
- Zoti Rinor Xherimeja me Numër Personal ID I90809059J lindur ne Berat me 09.08.1989

e mbledhur në përputhje me nenin 82 e vijues, nenin 81 pika b dhe c dhe nenin 87 të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar dhe statutin e Shoqërisë,


#### VENDOSI:

1. Të themelojë në Republikën e Shqipërisë shoqërinë "HËNËZA" shpk, e cila do t'i shërbejë përmbushjes së qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara në Statutin e kësaj Shoqërie.
2. Të miratohet Marrëveshja e Ortakëve datë 28.01.2022, bashkëngjitur këtij Vendimi si Aneks Nr. 1.
3. Të miratohet Statuti i Shoqërisë "HËNËZA" shpk bashkëngjitur këtij Vendimi si Aneks Nr.2.
4. Të emërohet Administrator i "HËNËZA" shpk **Znj. Marinela Xherimeja**, shtetase shqiptare me Nr. Personal ID **J55606060W** lindur ne Berat, me 06.06.1995, me adrese Rr. "Hamdi Pepa", Godina Nr. 18, Hyrja Nr. 1, Apartamenti 10, Tirane, e cila emërohet në këllë detyrë për një periudhë **5 (pesë vjeçare)**, me te drejtë ripërtëritje.
5. Autorizohet **Z. Rinor Xherimeja**, shtetas shqiptar me Numër Personal ID **I90809059J** për regjistrimin e këtij Vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.




Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve

MARINELA XHERIMEJA

Marinela Xherimeja 

RINOR XHERIMEJA

Rinor Xherimeja 

**AKTI I THEMELIMIT  
DHE STATUTI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“HËNËZA” SH.P.K.**

Tiranë, më 28 / 01 / 2022



## TABELA E PËRMBLEDHËSE

<b>DISPOZITA TE PERGJITHSHME .....</b>	<b>4</b>
Forma ligjore dhe emri i shoqërisë.....	4
Ortakët e shoqërisë dhe kapitali i regjistruar i saj.....	4
Kohëzgjatja.....	5
Selia kryesore .....	5
Objekti i aktivitetit .....	5
<b>ORGANET DREJTUESE DHE TË ADMINISTRIMIT TË SHOQËRISË.....</b>	<b>6</b>
Organet drejtuese .....	6
Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, kompetencat .....	6
E drejta e votes dhe kuorumi .....	6
Proçesverbalet e mbledhjes së Asamblesë.....	6
Emerimi i Administratorit .....	7
Kompetencat e përgjithshme të Administratorit.....	7
Shkarkimi i punonjesve; Doreheqja.....	7
Shkëmbimi i informacionit me Ortaket .....	7
Politikat e Administrimit.....	8
<b>KONTRIBUTET NE KAPITAL; SHPERNDARJA; BUXHETI.....</b>	<b>8</b>
Pagesa e kontributeve të kapitalit të rena dakord.....	8
Shperndarja fitimeve .....	8
Buxheti.....	8
Planet e biznesit .....	8
<b>KONTABILITETI; CESHTJE TATIMORE .....</b>	<b>9</b>
Viti Financiar.....	9
Librat e kontabilitet .....	9



Raportet periodike .....	9
Regjistrat.....	10
Auditet .....	10
<b>PRISHJA, SHNDËRRIMI DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË .....</b>	<b>11</b>
Mbyllja .....	11
Shndërrimi i shoqërisë.....	11
<b>DISPOZITA TE FUNDIT.....</b>	<b>11</b>
Kushtet dhe procedurat per transferimin e kuotave.....	11
Shqyrtimi i mosmarrëveshjeve.....	11
Hyrja në fuqi.....	11
<b>Aneksit I.....</b>	<b>12</b>
Kuotat /Kontributet në Kapital.....	12





Kreu I  
**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

Neni 1

**Forma ligjore dhe emri i shoqerise**

- 1.1 Shoqeria ka emertimin "HËNËZA" sh.p.k (ne vijim referuar si "**Shoqeria**"). Shoqeria gjithashtu mund te kryje aktivitet me emrin tregetar HËNA ose sipas cdo emri tjetër për të cilin bien dakord ortakët.
- 1.2 Shoqëria e realizon aktivitetin e saj, sipas objektit të përcaktuar në këtë statut, bazuar në legjislacionin shqiptar dhe marrëveshjen e ortakëve të lidhur ndërmjet **Znj. Marinela Xherimeja** dhe **Rinor Xherimeja**, me date 28/01/2022.
- 1.3 Shoqeria është e organizuar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "*Per Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare*" (në vijim "**Ligji i shoqërive tregëtare**") dhe aktet e brendshme të shoqërisë.

Neni 2

**Ortakët e shoqërisë dhe kapitali i regjistruar i saj**

- 2.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 1000 ALL dhe ndahet në 2 kuota, të cilat zotërohen nga ortakët e saj.
- 2.2 Ortakët e Shoqërisë janë:
- 2.3 Znj. Marinela Xherimeja, shtetas shqiptar me letërnjoftim ID nr. J55606060W (në vijim referuar si "**Ortaku i Parë**"),
- 2.4 Z. Rinor Xherimeja, shtetas shqiptar me letërnjoftim ID nr. I90809059J (në vijim referuar si "**Ortaku i Dytë**"), Në vijim të dy ortakët bashkarisht do të referohen si "**Ortakët**".
- 2.5 Ortaku i Parë zotëron 1 kuota me vlerë nominale 500 Lekë, që përfaqëson 50% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe të të drejtave të votës në asamblenë e përgjithshme të ortakëve sipas këtij statuti.
- 2.6 Ortaku i Dytë zotëron 1 kuota me vlerë nominale 500 Lekë, që përfaqëson 50% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe të të drejtave të votës në asamblenë e përgjithshme të ortakëve sipas këtij statuti.
- 2.7 Në përputhje me dispozitat e këtij statuti, një person mund të pranohet kohë pas kohe si ortak në Shoqëri vetëm nëse ky ortak i ri do të nënshkruajë një amendament sipas të cilit ortakët i ri bien dakord t'i përmbahet kushteve e termave të këtij statuti.
- 2.8 Ortakët përgjigjen për humbjet e Shoqërisë deri në vlerën e kapitalit themelues të saj.



### Neni 3

#### Kohëzgjatja

- 3.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë kohore me afat të pacaktuar.
- 3.2 Afati i përmendur në pikën 1 të këtij neni mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga ky Statut.

### Neni 4

#### Selia kryesore

- 4.1 Selia kryesore e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë në adresën **Rr. "Hamdi Pepa", Godina Nr. 18, Hyrja Nr. 1, Apartamenti 10, Tiranë, Shqipëri**. Shoqëria mund të ketë zyrë të tjera në vende të tjera sikunder mund të vendoset nga Ortaket here pas here.
- 4.2 Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyrë përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.
- 4.3 Selia e shoqërisë mund të transferohet kudo brenda territorit të Republikës së Shqipërisë me një vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

### Neni 5

#### Objekti i aktivitetit

- 6.1 Kompania do të ushtrojë aktivitet tregëtar në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke përfshirë por pa u kufizuar në:
    - a. Import, eksport, shitje dhe blerje të pajisjeve teknologjike dhe inovative;
    - b. Import, eksport, shitje dhe blerje të metrazheve, aksesore rrobaqëpsie dhe bizhuterie.
    - c. Import, eksport, shitje dhe blerje të artikujve industrial, elektronik, elektrik dhe informatik.
    - d. Import, eksport, shitje dhe blerje të materialeve drusore, aksesor mobilerie dhe duralumin.
    - e. Tregëtim konfeksione të ndryshme për të rritur dhe femije.
    - f. Tregëtim prodhimesh kozmetike e estetike.
    - g. Tregëtim montim riparim pajisjesh elektro-shtëpiake, elektronike elektrike, kompjuterike, etj.
    - h. Librari, kancelari, lodra, dekorë festive, shërbime printimi, ndërtim software, mirëmbajtje faqesh web, tregëtim mjetesh dhe pajisje mjekësore përfshirë maskat dhe pajisje të tjera mbrojtëse.
    - i. Eksport - Import si dhe tregëti me shumicë dhe pakicë të pajisjeve kompjuterike, pjesë të ndryshme këmbimi, aksesore, servis të pajisjeve kompjuterike.
    - j. Shërbime dhe konsulence në fusha të ndryshme, formim dhe mësimdhënie. Shërbimeve të konsulences në fusha të ndryshme: (sociale dhe psiko-sociale, ligjore, mjekësore, bujqësore, blegtorisë, pyjeve, peshkimit, ujrave) etj.
- Çdo veprimtari tjetër të dobishme në interes të shoqërisë.





## Kreu II

# ORGANET DREJTUESE DHE TË ADMINISTRIMIT TË SHOQËRISË

### Neni 6

#### Organet drejtuese

Organet drejtuese të Shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
- Administratori.

### Neni 7

#### Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, kompetencat

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve (ne vijim refersuar si "Asambleja") gëzon çdo kompetencë të parashikuar në nenin 81 të Ligjit për shoqëritë tregëtare dhe ato të përcaktuara në Marrëveshjen e Ortakëve.

### Neni 8

#### E drejta e votes dhe kuorumi

- 9.1 Asambleja do të thirret e do të mbahet në përputhje me kërkesat e Ligjit të Shoqërive Tregëtare dhe akteve të brendshme të shoqërisë. Përveç rasteve kur bëhet dakord ndryshe nga Ortaket, Asambleja do të mbahet në selinë e shoqërisë.
- 9.2 E drejta e votes në Asamble do të jetë në proporcion me zoterimin e kuotave nga secili Ortak. Secili prej Ortakëve ka të drejtë të propozojë çështje që do të përfshihen në rendin e ditës së Asamblese.
- 9.3 Asnjë vendim i vetëm i Asamblese nuk mund të bëhet pa kuorumin e kërkuar sipas Marrëveshjes së Ortakëve.

### Neni 12

#### Procesverbalet e mbledhjes së Asamblesë

- 12.1 Te gjitha vendimet e Asamblese duhet të regjistrohen në procesverbal. Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendit të mbledhjes, rendin e ditës emrin e kryesuesit të mbledhjes dhe të mbajtësit të procesverbalit, si dhe rezultatet e votimit. Kryesuesi i mbledhjes mund të jetë njëri prej ortakëve ose personi që ka thirrur mbledhjen, ndërsa mbajtësi i procesverbalit (sekretari) zgjidhet nga kryesuesi i mbledhjes.
- 12.2 Procesverbalit i bashkëlidhet dhe akti i thirrjes së Asamblese.
- 12.3 Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga ortakët dhe sekretari i mbledhjes.



## Neni 13

### **Emerimi i Administratorit**

Shoqeria do te administrohet ne aktivitetin e perditshem nga nje Administrator Znj. Marinela Xherimeja me ID J55606060W (ne vijim referuar si "**Administratori**"). Administratori do te emerohet pa afat por mund te ndryshohet nga Asambleja e Ortakeve ne cdo kohe.

## Neni 14

### **Kompetencat e pergjithshme te Administratorit**

Administratori do te raportoje ne menyre direkte dhe ekskluzive te Ortaket dhe do te zbatoje te gjitha urdhrat dhe vendimet e Ortakeve. Administratori eshte i autorizuar te kryeje te gjitha veprimet ne emer dhe per llogari te Shoqerise ne perputhje me kete Statut, Marrëveshjen e Ortakëve, planin e biznesit, buxhetin dhe politikat dhe procedurat e percaktuara nga Ortaket. Te gjithë punemarresit e Shoqerise do te raportojne te Administratori ose te personat e autorizuar prej tij.

## Neni 18

### **Shkarkimi i punonjesve; Doreheqja**

- 18.1 Cdo punemarres i Shoqerise, perfshire edhe Administratorin, mund te shkarkohet nga Asambleja ne cdo kohe me ose pa arsye sa here qe ne gjykimin e saj do te sherbeje apo do te jete ne interesin me te mire te Shoqerise.
- 18.2 Punemarresit e emeruar nga Administratori mund te shkarkohen nga ata ose detyrat e tyre mund te ndryshohen ne menyre substanciale nga ata, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.
- 18.3 Administratori mund te heqe dore nga pozicioni i tij duke i dhene ortakeve nje njoftim me shkrim. Pervec rasteve kur percaktohet ndryshe ne ate njoftim, doreheqja hyn ne fuqi pas marrjes se ketij njoftimi nga ana e Ortakeve, dhe pranimi i doreheqjes nuk eshte i nevojshem per ta bere ate efektive. Deri ne zevendesimin e Administratorit i cili eshte shkarkuar ose jep doreheqjen, Ortaket kane te drejte te caktojne nje zevendesues te perkohshëm, ose per te ushtruar perkohesisht detyren e Administratorit, deri në emerimin e nje Administratori te ri nga ana e Asamblese sipas percaktimeve te ketij statuti.

## Neni 19

### **Shkembimi i informacionit me Ortaket**

- 19.1 Administratori do t'i jape secilit prej ortakeve te gjithë informacionin ne lidhje me aktivitetin e Shoqerise i cili kerkohet ne menyre te arsyeshme nga keta Ortake, perfshire marredheniet me pale te treta dhe shoqerite e lidhura, ne menyre qe te sigurojne ne menyre te arsyeshme kete Ortak se veprimet e Administratorit do te jene ne interesin me te mire te Shoqerise dhe se nuk do te vene ne disavantazh te nje ortaku kundrejt tjetrit.

- 19.2 Me miratimin e buxhetit operacional vjetor nga ortakët, secili ortak do të vendosë sa shpesh ky ortak dhe Administratori duhet të takohen për të diskutuar progresin drejt objektivave operacionale të Shoqërisë.
- 19.3 Administratori do t'i japë secilit ortak informacion të plotë në lidhje me aktivitetin e Shoqërisë në mënyrë që rezultatet financiare të Shoqërisë në çdo moment të jenë të parashikueshme nga secili ortak.

Neni 20

#### **Politikat e Administrimit**

- 20.1 Administratori, punëmarresit me pozicione drejtuese si dhe të punësuarit e tjerë të Shoqërisë do të përgatisin dhe do të implementojnë politikat e administrimit sipas dhe në përputhje me politikat e përgjithshme dhe programet e miratuara të Asamblesë, planit të biznesit dhe buxhetit.
- 20.2 Përveç se kur kërkohet ndryshe nga Ortakët, Administratori do të marrë pjesë në Mbledhjet e asamblese.

Kreu III

### **KONTRIBUTET NE KAPITAL; SHPERNDARJA; BUXHETI**

Neni 21

#### **Pagesa e kontributeve të kapitalit të rena dakord**

Secili nga Ortakët do të japë kapital për Shoqërinë në përputhje me Marrëveshjen e Ortakëve.

Neni 22

#### **Shpërndarja fitimeve**

Shpërndarja e fitimeve të Shoqërisë, ortakëve të saj, bëhet në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe parashikimeve të Aneksit I.

Neni 23

#### **Buxheti**

Buxheti i Shoqërisë do të përgatitet, miratohet dhe zbatohet në përputhje me parashikimet e Aneksit I.

Neni 24

#### **Planet e biznesit**

Planet e biznesit të Shoqërisë do të përgatitet, miratohet dhe zbatohet, në përputhje me parashikimet e këtij statuti.



## Kreu IV

### KONTABILITETI; CESHTJE TATIMORE

#### Neni 25

##### Viti Financiar

Llogaritja e shpenzimeve, të ardhurave dhe fitimit për Shoqërinë bëhet për çdo vit financiar. Çdo vit financiar fillon më datën 01 Janar dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

#### Neni 26

##### Librat e kontabilitet

Shoqëria do të mbajë librat kontabel të aktivitetit të shoqërisë, në mënyrë të plotë dhe të duhur, në seline qendrore të saj si dhe në çdo vend tjetër që do të vendoset nga Asambleja apo kërkohet nga legjislacioni. Këto libra do të përfshijnë, por pa u kufizuar në, të gjithë të ardhurat, shpenzimet, asetet dhe detyrimet e shoqërisë.

#### Neni 27

##### Raportet periodike

- 27.1 Shoqëria do të përgatisë dhe dërgojë tek secili ortak, sa më shpejt të jetë praktikisht e mundur, në formën dhe përmbajtjen e përcaktuar, sa më poshtë:
- Një buxhet vjetor dhe një plan biznesi parashikues tre vjeçar të rishikuar (i përditësuar çdo vit) për Shoqërinë jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë para fillimit të çdo viti financiar;
  - Llogaritë e audituara të shoqërisë nga momenti që behen të disponueshme, por në çdo rast jo më vonë se 4 muaj nga data e fundit të çdo Viti Financiar;
  - Llogaritë manaxheriale tremujore të paaudituar të shoqërisë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas fundit të çdo tremujori;
- 27.2 Shoqëria do të mbyllë librat kontabel pas mbylljes së çdo muaji në çdo vit financiar. Çdo raport mujor do të përfshijë gjithashtu një buxhet që parashikon fitimet dhe humbjet dhe bilancin për shoqërinë. Shoqëria do të paraqesë këto raporte dhe çdo raport shtesë që mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme si dhe kur kërkojë për të përmbushur secilin prej praktikave raportuese financiare të secilit Ortak rast pas rasti, gjithnjë duke u përshatur në varesi të ngarkesës së punës së stafit të shoqërisë.
- 27.3 Ortaket do të bashkëpunojnë plotësisht me njëri-tjetrin dhe t'i paraqesin njëri-tjetrit në bazë të kërkesës, të gjithë informacionin financiar të nevojshëm dhe analizën përkatëse të llogarive lidhur me interes respektive në shoqëri.

27.4 Nëse Administratori i shoqërisë nuk përmbushin detyrimet e tyre sipas këtij neni brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e përcaktuar ose në dy ose më shumë raste të njëpasnjëshme, ortakët i interesuar mund të emërojnë ekspertë kontabel, të paraqiten në zyrtarë të shoqërisë, të hetojnë dhe të përgatisin dokumentat. Shoqëria dhe nepunësit e shoqërisë duhet të bashkëpunojnë me ekspertët kontabel dhe Shoqëria duhet të paguajë tarifën e ekspertëve kontabel dhe shpenzimet për ta, përveç rastit kur mospërmbushja ka ardhur për shkak të Administratorit të emëruar nga ortakët që ka caktuar ekspertin kontabel si më lart; në këtë rast tarifën dhe shpenzimet e ekspertit do të paguhet nga ortakët i interesuar.

Neni 28

### **Regjistrat**

28.1 Shoqëria do të mbajë në shtet qendror të saj, libër dhe regjistrat në mënyrë të duhur të kërkuar nga legjislacioni shqiptar në fuqi. Përveç sa më sipër, shoqëria do të mbajë në shtet qendror të saj sa më poshtë vijon:

- a. Një listë aktuale të emrit të plotë dhe të adresës së fundit të bërë me dije nga secili ortak;
- b. Një kopje të këtij statuti dhe të gjitha ndryshimeve të tij;
- c. Kopje të deklaratave dhe raporteve të mëtejshme të shoqërisë, nëse ka, të 3 (tre) viteve financiare të fundit;
- d. Kopje të pasqyrave financiare, nëse ka, të shoqërisë të 5 (pente) viteve financiare të fundit; dhe
- e. Çdo dokument tjetër në lidhje me aktivitetin e Shoqërisë të kërkuar mund të kërkuar në mënyrë të arsyeshme rast pas rasti me vendim të Asamblesë.

28.2 Përveçse kur parashikohet ndryshe nga legjislacioni shqiptar në fuqi, shoqëria do të japë çdo ortak, me kërkesë të këtij të fundit, informacion mbi Shoqërinë, shitjet e saj, faturat, pagesat, çdo informacion kontabel dhe regjistrimet si dhe të gjitha aktivitetet e shoqërisë. Çdo ortak dhe përfaqësuesit e tij do të jenë të lirë të diskutojnë mbi veprimtarinë dhe aktivitetin e Shoqërisë me Administratoren dhe t'i kërkojnë këtyre të fundit që t'i japin kopje të të gjithë librave, regjistrimeve dhe informacione të tjera në lidhje me veprimtarinë dhe biznesin e shoqërisë.

Neni 29

### **Auditet**

Ortakët bien dakord të caktojnë auditet të njohur financiarë ndërkombëtarë që të kryejnë auditimin vjetor të pasqyrave financiare të shoqërisë.





Kreu VI

**PRISHJA, SHNDËRRIMI DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

Neni 31

**Mbyllja**

Shoqëria do të mbyllet dhe aktiviteti i saj do të perfundojë, nëse Asambleja e Ortakëve bie dakord.

Neni 32

**Shndërrimi i shoqërisë**

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore sipas legjislacionit në fuqi dhe ketij.

Kreu VII

**DISPOZITA TE FUNDIT**

Neni 30

**Kushtet dhe procedurat për transferimin e kuotave**

Transferimi i kuotave të Ortakëve do të kryhet vetëm në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara në Aneksin I.

Neni 33

**Shqyrtimi i mosmarrëveshjeve**


Kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që mund të lindin gjatë ekzistencës së Shoqërisë është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.


Neni 34

**Hyrja në fuqi**

Ky Statut është i hartuar në dy kopje në gjuhën shqipe dhe hyn në fuqi me miratimin dhe depozitimin e tij pranë Regjistrisë Tregtare.

**Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve**

Znj. *Marimela Xherimeja* 

Z. *Rinor Xherimeja* 

## Aneksit I

### Kuotat /Kontributet në Kapital

Emri i Palës	Kontributi në Kapital ne Lekë	Numri i kuotave	Përqindja e Interesit
Marinela Xherimeja	500	1	50%
Rinor Xherimeja	500	1	50%

